

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Në “gjueti” të shoferëve rebelë! Kamera e Vizion Plus, një natë me Policinë Rrugore në zonat problematike – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/ne-gjueti-te-shoferëve-rebelë-kamera-e-vizion-plus-nje-nate-me-policinë-rrugore-ne-zonat-problematike/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 22:45:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 18:07:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5bb05ffb65e9c4048d91d951c9f6ee2e0808f57618b218b5672ea6222e505326
TEKSTI	b96fb4ca20bb12e6b9678ff11cd3a82f936e14e450e688433e6089248a3e323e
PAMJA	40deaa8228fa37d0957edf03923e5908aeb7c7cbda30f9db800248b049078674

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2be01e70b79aa1d5c5ffb277d58502fa8d789dd3c0b9a79de71643baaee8565d
E MËPARSHMJA	d1f53a6571e1813b8dae1f9b375705940c17543615cd51e927effff270c38230
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2be01e70b79aa1d5c5ffb277d58502fa8d789dd3c0b9a79de71643baaee8565d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ngadaltë, nata në kryeqytet ndryshon kryekëput rregullat e lojës. Ndërsa pjesa më e madhe e qytetit pushon, për Policinë Rrugore puna sa vjen e ndërlikohet. Shpejtësi tej normave, alkool pas mesnate dhe gara të paligjshme. Kamera e Vizion Plus ka ndjekur nga afër, hap pas hapi, punën e efektivëve të rrugorës në terren në akset më problematike të kryeqytetit.

Ndodhemi në Unazën e Madhe, një nga akset më të rëndësishme, por nga ana tjetër edhe më të rrezikshme gjatë orëve të vona të natës në kryeqytet. Pikërisht asfalti i drejtë i kësaj rruge shpesh herë përdoret si pistë e improvizuar gara me automjete ndaj policia rrugore shpesh herë patrullon në këtë aks rrugor për të ndëshkaur të gjithë shkelësit e Kodit Rrugor. Pak km më shumë në orë në këtë aks rrugor, mund të kthejë një rrugëtim të sigurt në një tragjedi.

Shefi i trafikut urban Jetnor Shira rendit shkeljet kryesore të evidentuara gjatë orëve të vona të natës në akset më problematike që monitorohen nga policia rrugore.

“Për sa i përket aksit rrugor nga mbikalimi i Saukut deri te pallati me shigjeta, ose komplet pjesa e Unazes Veriore, është një aks interurban kryesor ku shpejtësia është e lartë dhe jo rrallë herë përdoret nga drejtuesit e mjeteve qoftë për gara me shpejtësi, qoftë për zhurmat ndotjet akustike dhe kontrolli, pra monitorimi bëhet me pajisje teknologjike të mjeteve inteligjente dhe të radarëve për konstatimin e mjeteve që tejkalojnë normat e shpejtësisë ose të konstatimit të mjeteve që shkaktojnë zhumra me anë të shkarkimit të marmitave”, tha Shefi i trafikut urban Jetnor Shira.

5 Rama: Meta ishte një talent në politikë, por e “përpiu” pushteti

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

Për këto kontrolle, janë të nevojshme patrullime shtesë për shkak të shkeljeve të shumta që hasen çdo ditë.

“Për sa i përket planizimit, ata monitorohen me patrulla shtesë, plus të shërbimit të radarit osë të mjetit inteligjent, pra patrullohet edhe me shërbime shtesë të cilat janë planizuar për kontrollin e këtyre shkeljeve. Mjetet që konstatohen, krahas masave, ose kontrolleve që u bëhet për marmitat pra për zhurmat, ushtrohet kontroll edhe për xhamat e zi, dokumentacioni, ushtrohet test për përdorimin e alkoolit dhe aty ku ka dyshime të arsyeshme dhe për lëndët droguese”, u shpreh Shira.

Ata që konsiderohen si pilotët e asfaltit dhe përdorin Unazën e Madhe për gara me makina, me manovra teper të rrezikshme për jetën e tyre janë në vëmendjen e policisë rrugore. Makina që kapen nga radarët jo me pak, por edhe më shumë se 200 km/h.

“Jo pak janë rastet e konstatimit të këtyre kategorive dhe me rritjen e penaltetit për mosrregullimin e shpejtësisë për sa i përket manovrave të gabuara, ose ato të rrezikshme duke u bërë burim për aksidente, qoftë për veten e tyre ose për përdoruesit e tjetër të rrugës, pra shfaqet agresive. Rastet janë jo të pakta dhe të garave me shpejtësi. Ka raste të konstatimit edhe me 190 km/h ose me 210 km/h që janë mjaft të rrezikshme dhe jo pak herë janë përfshirë në ngjarje rrugore”, tha Shefi i trafikut urban Jetnor Shira.

Një tjetër fenomen shqetësues janë edhe zhurmat që shkaktojnë motorat, apo makinat luksoze. Zhurma që krijohen me qëllim nga drejtuesit e mjeteve për të tërhequr vëmendjen e qytetarëve, zhurma që sjellin shqetësim te qytetarët sidomos gjatë orëve të vona të natës. Këto manovra bëhen vetë nga shoferët e rinj kryesisht duke modifikuar marmitat.

“Rastet e konstatimit, ose shqetësimet më të mëdha janë zhurmat akustike, sidomos ato që shkaktohen nga motorat të cilët janë me kubikë të lartë dhe kontrolli është më i madh sidomos ndaj këtyre mjeteve me kubikë të mëdha, ose mjetet e reja dhe mjetet e luksit. Aty ku kemi dyshime të arsueshme që ka ndërhyrje në sistemin e zhurmë/shkarkimit të marmitave bëhet shoqërimi i tyre në Komisariat ose në Drejtoritë përkatëse më të afërta për të bërë kontrollin teknik. Jo në pak raste janë konstatuar me ndërhyrje e zhurmë/shkarkimit”, deklaroi Jetnor Shira.

Shira tregon se drejtuesit e rinj shpesh herë kapen në shkelje të Kodit Rrugor. Duke ngarë makina luksoze, ata janë një rrezik i lartë në rrugë.

Ndryshimet e fundit ligjore parashikojnë që ata të udhëtojnë brenda disa kornizave me limite të caktuara në Kodin Rrugor, qoftë për shpejtësinë, apo për modelin që do të ngasin në rrugë për vitet e para të marrjes së lejes së drejtimit.

“Kohët e fundit janë hartuar edhe planet e masave për shkak të shqetësimeve dhe për shkak të aksidenteve të ndodhura, por edhe për shkak të ndryshimeve të Kodit Rrugor të cilat prekin kategorinë e drejtuesve të mjeteve që janë me një eksperiencë më pak se 2 vite në drejtimin e mjetit. Ata kanë dhe kushtëzime sa i përket limitit të shpejtësisë, në rrugët interurbane deri në 90km/h dhe në rrugët urbane deri në 80 km/h. Për drejtuesit e rinj për shkak se është bërë dhe kushtëzime të limitit të shpejtësisë tejkalimi i tyre ose përsëritja është edhe me heqje të pikëve, pra me përsëritje u dyshishohet heqja e pikëve, u

dyfishohet edhe masa administrative, por edhe dyfishim i bllokimit të lejes së drejtimit”, nënvizoi ai.

Kamera e Vizion Plus ndoqi nga afër dhe punën e mjeteve inteligjente që pikasin mjetet që ecin me shpejtësi.

Ky është momenti kur radari pulson dhe tregon shkelësin e rrugës. Me një shpejtësi thuhet 40 km/h më shumë se norma e lejuar, kjo makinë është burim serioz për aksidente.

Pasi drejtuesi i mjetit vendoset në dijeni për shkeljet që ka kryer duke ia faktuar me foto dhe me pamje reale të mjetit të tij, efektiv i Rugorës i pret faturën e gjobës, dhe vendos masat plotësuese siç janë ulja e pikëve të patentës. Më pas mjeti lihet i lirë.

Probleme të shumta të qarkullimit rrugor hasen edhe në zemër të Tiranës. Më të shumta janë parkimet e gabuara. Ky automjet është i parkuar në mes të Tiranës në trotuar. Drejtuesja e makinës duket se ka zgjedhur që të bllokojë trotuarin duke penguar lëvizjen e këmbësorëve, sesa të parkojë përballë tek hapësirat që ofron Bashkia e Tiranës kundrejt pagesës.

Përgjigja ndaj këtyre parkimeve mbetet karroatreci.

Ndonëse në Unazën e Madhe problem më kryesor mbetet shpejtësia, në zonat urbane dhe kryesisht në zonën e ish-Bllokut problem më i madh mbetet përdorimi i alkoolit. Drejtuesit e mjeteve të cilët ndalohen nga policia do t'i nënshtrohen një testi për të vertetuar nëse kanë konsumuar alkool ose jo.

Alkool dhe drogë. Nuk janë të pakta rastet, sidomos gjatë fundjavave. Makinat luksoze ku në drejtimin e tyre janë kryesisht moshat e reja ndalohen për testet e alkoolit.

“Në pjesën e fundjavës, për shkak se edhe fluksi është më i shtuar ndahemi në tre etapa kontrolli. Një grup kontrolli për parkimet e gabuara, praktikimet në trotuar, kalime këmbësorësh. Një grup pune në pjesët periferike për manovrat e gabuara, sjelljet agresive, mosrregullimi i shpejtësisë dhe për shkak të popullimit të tepërt në pjesën e lokaleve të natës për përdorimin e pijeve alkoolike, ushtrijmë kontroll në pjesën e ish-Bllokut dhe në pjesën e Rrugës së Elbasanit që kanë fluks më tepër për kontrollin e pijeve alkoolike. Rastet më të shumta jën nën 0.5. Ka edhe raste sporadike që konstatohen në gjëndje të dehur edhe më shume se 0.5 të cilët shoqërohen në komisarate dhe arrestohen sepse përbën vepër penale. Ndërsa rastet që kapen më pak se 0.5 mg për litër procedohet duke vendosur masën administrative dhe penaltete sipas sanksioneve plotësuese”, tha Jetnor Shira.

Jo vetëm alkool por edhe të droguar të kapur në drejtimin e mjetit.

“Në raste kur kemi dyshime të arsyetueshme për përdorimin e lëndëve narkotike bëjmë shoqërimin e tyre në Komisarjat ku kryhet edhe testi për lëndët narkotike”, u shpreh Shira.

Këto pamjet tregojnë momentin kur një shofer i ndaluar nga rrugorja është përcjell në Komisarit për tju nënshtuar testit të drogës. Rezultati është pozitiv. I riu nën efektin e lëndëve narkotike drejtonte mjetin duke bërë manovra të rrezikshme.

Trafiku i rënduar në kryeqytet ka bërë që të rriten kontrollet për monitorimin e sigurisë rrugore. Sipas statistikave, sidomos gjatë sezonit

veror, blutë vendosin afro 2500 gjoba në 24 orë, kryesisht për shpejtësi, përdorim celulari, parakalime të gabuara, apo manovra të rrezikshme në rrugë.

Megjithatë edhe pse ka një ashpërsim të kodit rrugor, drejtuesit e mjeteve duket se ende nuk janë ndërgjegjësuar që të zbatojnë plotësisht normat e qarkullimit, duke eliminuar rrezikun e përfshirjes në aksidente, ku jo në pak raste janë shënuar viktima.

/vizionplus.tv

#PoliciRugore

#VizionPlus

#zonatproblematike



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Më shumë video

VIDEO

Breshëria e plumbave në Mat, kush ishte...

Xhuljana Zhuleku · Dje 14:17

VIDEO

Mesazh me plumba ndaj një gruaje?!...

Xhuljana Zhuleku · Dje 12:19

VIDEO

Shpërthimi me tritol në Shkodër, policia j...

Taulant Halili · Dje 00:27



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.